

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

29 Qershor 2020

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

1. Informacion i përgjithshëm.

Shoqëria “Alstezo” sha është themeluar me vendimin nr.13950, date 31.10.1995 te Gjykares Tirana, eshte regjistruar në Drejtorine Rajonale Tatimore Fier, me nipt J63208420N. Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” i ndryshuar, nga statuti dhe Legjislacioni ne fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë “Alstezo” shpk është: Shoqëria do te kryeje aktivitetin e meposhtem: Ndertim objektesh mbi tete kate. Autoshkolle per pergatitjen e te gjithë kategorive te drejtuesve te mjeteve motorrike, per te gjitha shkallet dhe kategorite, autoservis, kolaudim te te gjithë llojeve te automjeteve dhe parking, import-eksport dhe tregti me shumice e pakice te materialeve te pjeseve te kembimit per automjete dhe autotraktora 2 te tipeve te ndryshme, dhe import-eksport e tregtim te makinerive dhe paisjeve per autoservise. Lyerjen, lustrimin, ringjyrosjen dhe risprucimin e makinave dhe mjeteve te transportit rrugor. Larje mjetesh motorrike. Tregti me shumice te vajrave lubrifikante lloji "A", Kategoria IV/A.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është z. Albert Zogo. Selia e Shoqërisë është në Lagjia Kryengritja e Fierit, Fier.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në



[Handwritten signature]
0979 gwer
13.01.20

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha (Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël


Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

1. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1.1 Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi



Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

1.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi fluksin e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- **Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- **Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.



Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

1.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.



Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha **(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

1.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi


Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Paj, zyre e informat	Vlera e mbetur	20%
Aktive afatgj jo-materiale	Vlere fillestare	15%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata



Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha (Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.


3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 6.7% (2018: 6.6%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato



Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha (Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



6979

13.07.20

Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

AKTIVET AFATSHKURTRA

Aktive monetare për 20.842.755 lekë, perfaqesojne mjete monetare ne banke.

Shoqeria operon vetem me disa banka ne leke dhe euro, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditaret perkates, me llogarite ne valute veprimet jane kryer me kursin ditor te bankes, ndersa gjendja e monedhave te huaja ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kursin e Bankes se Shqiperise me date 31.12.2019 duke kaluar sipas rastit ne llogarite e shpenzimeve apo te ardhurave diferencat e kembimit.

Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit në vlerën 153.650.277 leke perfaqeson llogarine Kliente per vleren e faturave te paarketuara. Kjo llogari eshte e analizuar sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike te tyre.

Te tjera te drejta te arketueshme ne shumen 2.960.742 leke paraqesin:

- **Tatim fitimi** i mbipaguar ne shumen 335.722 leke i shoqerise Nuovauto shpk e cila eshte perthithur nga shoqeria Alstezo sha ne vitin 2014.
- **Tatim fitimi** ne shumen 636. 412 leke.
- **Tvsh ne dogane** ne shumen 16.669 leke
- **Ngurtesime** ne shumen 432.030 leke paraqet fonde te ngurtesuara per garanci ne tendera.
- **Te tjera te drejta** ne shumen 1.539.909 leke paraqet detyrim te te treteve ndaj shoqerise.

Ne llogarite **Inventariale** shoqeria ka paraqitur gjendjen e mallrave ne shumen 41.852.506 leke. Vleresimi i tyre ne fund te ushtrimit eshte bere me kosto faktike.

Parapagime per inventar ne shumen 6.583.059 leke.

Aktivitet afatgjata materiale

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh afatgjata materiale ne shumen 264.469.952 lekë e cila perfaqeson vleren e mbetur te ndertesës, mjeteve te transportit, pajisjeve te punes, pajisjeve te zyres dhe informatike. Aam jane shtuar gjate vitit 2019 ne shumen 18.885.619 leke ne zerin ndertime me shumen 13.996.702 leke, mjete pune me shumen 1.564.000 leke, mjete transporti ne shumen 1.409.983 leke dhe inventar ekonomik ne shumen 1.914.934 leke. Aam jane pakesuar per amortizimin e llogaritur ne shumen 20.295.155 leke.

DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitalet e veta paraqiten me vlerë 178.561.588 leke.

Kapitali i rregjistruar i shoqërisë është 145.967.000 lekë, i perbere nga nje kuote e cila i perket ortakut te vetem te shoqerise z. Albert Zogo.




0974
73.05.20

Shenime mbi pasqyrat financiare

"Alstezo" sha (Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

Rezerva ligjore ne shumen 798.294 leke e krijuar nga fitimi i ushtrimit 2018 sipas vendimit te asamblese se ortakeve mbi miratimin e pasqyrave financiare te ketij viti e mbajur date 21.06.2019.

Rezerva te tjera ne shumen 15.167.766 eshte shtuar nga viti kaluar ne shumen 15.167.577 leke sipas vendimit te asamblese date 21.06.2019.

Fitimi i ushtrimit sipas bilancit kontabël paraqitet ne shumen 16.628.528 lekë.

Detyrimet

Detyrimet me vlerë 311.797.703 lekë përfaqësojnë:

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Detyrime ndaj institucioneve te kredise	241.664.183	217.778.455
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	66.851.323	59.084.075
Te pagueshme ndaj punonjesve e sigurimeve shoqerore	1.594.959	1.184.240
Detyrime tatimore	935.320	700.831
Te tjera detyrime	751.918	
Totali	311.797.703	278.747.601

Detyrime ndaj institucioneve te kredise paraqet:

- Overdraft ne Intesa Sanpaolo ne shumen 38.543.150 leke,
- Kredi afagjate nga Intesa Sanpaolo ne shumen 203.121.033 leke

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 66.851.323 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqitet detyrim per pagat ne shumen 1.206.269 leke dhe sigurime per muajin dhjetor 2019 ne shumen 388.690 leke.

Detyrimet tatimore paraqesin:

- **Tatimi mbi pagen** per 43.550 leke, detyrim per muajin dhjetor 2019.
- **Tatim ne burim** tatim qeraje ne shumen 4.951 leke.
- **Tvsh** ne shumen 886.819 leke.

Te tjera detyrime ne shumen 751.918 paraqet detyrim te shoqerise ndaj te treteve.

Verifikimi i llogarise Fitime Humbje

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Te ardhura		
Nga shitja e mallrave dhe sherbimeve	290.132.872	256.399.542
Te ardhura te tjera nga vepr. shfrytez	781.000	




07/11/20
73.07.20

Shenime mbi pasqyrat financiare

"Alstezo"sha (Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

Totali i te ardhurave	290.913.872	256.399.542
Materiale te konsumuara	213.575.587	193.946.694
Kosto e punes	15.325.659	16.151.388
Pagat e personelit	13.132.527	13.840.062
Shpenzimet per sigurime	2.193.132	2.311.326
Amortizimi dhe zhvleresimet	20.295.155	34.425.954
Shpenzime te tjera	15.854.880	17.115.363
Totali i shpenzimeve	265.051.281	261.639.399
Shpenzime interesi	(6.717.631)	(6.892.362)
Diferencat nga kembimi	467.698	543.230
Fitimi bruto	19.612.658	18.805.527
Tatim fitimi	2.984.130	2.839.656
Fitimi neto	16.628.528	15.965.871

Shpenzimet jane 271.768.912 leke, ndersa te ardhurat 291.381.570 lekë. Rezultati neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj gjate ketij viti ushtrimor është fitim ne shumen 16.628.528 leke.


Te ardhurat e realizuara gjate ushtrimit perfaqesojne: te ardhura nga shitja e mallrave dhe sherbimeve ne shumen 290.132.872 leke, te ardhura nga qerate ne shumen 781.000 leke, si edhe nga diferenca pozitive kembimi ne shumen 467.698 leke. Shitjet jane rregjistruar korrekt ne librat e shitjeve dhe te ardhurat rakordojne me situaten tatimore.

Shpenzimet per 271.768.912 lekë, jane te justifikuara me dokumenta te rregullta fiskale. Më konkretisht shpenzimet sipas zërave janë si më poshtë:

Shpenzime per materiale ne shumen 213.575.587 lekë, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta te rregullta tatimore.

Personeli, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 13.132.527 lekë, sigurime shoqërore 2.193.132 lekë, listëpagesat janë përpiluar saktë dhe shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari. Nje permbledhje te listepagesave si me poshte :

muajt	pg. bruto	Pg. kontrib	Punedhensi	punemarresi	Shendetesor	Totali Sigurime	tapi	nr. pun
Janar	1,077,229	1,077,229	161,584	102,337	36,626	300,547	30,940	32
Shkurt	1,071,000	1,071,000	160,650	101,745	36,414	298,809	30,940	31
Mars	1,049,999	1,049,999	157,500	99,750	35,700	292,950	28,440	31
Prill	1,016,000	1,016,000	152,400	96,520	34,544	283,464	28,340	30
Maj	969,000	969,000	145,350	92,055	32,946	270,351	25,740	30
Qershor	987,000	987,000	148,050	93,765	33,558	275,373	25,740	29
Korrik	1,027,000	1,027,000	154,050	97,565	34,918	286,533	25,740	31
Gusht	1,002,000	1,002,000	150,300	95,190	34,068	279,558	25,740	30
Shtator	1,041,000	1,041,000	156,150	98,895	35,394	290,439	27,040	31
Tetor	1,092,993	1,092,993	163,949	103,834	37,162	304,945	29,640	32
Nentor	1,406,153	1,406,153	210,923	133,585	47,809	392,317	43,550	38
Dhjetor	1,393,153	1,393,153	208,973	132,350	47,367	388,690	43,550	36
	13,132,527	13,132,527	1,969,879	1,247,591	446,506	3,663,976	365,400	32



Shenime mbi pasqyrat financiare

“Alstezo”sha
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

Amortizimi ne shumen 20.295.155 leke nuk kalon kufijte tatimor.

Shpenzime te tjera per 15.854.880 leke paraqesin:

- shpenzime per energji +gaz 2.139.753 leke,
- shpenzime per qera ne shumen 1.056.181 leke,
- shpenzime per siguracione ne shumen 198.483 leke,
- shpenzime reklame ne shumen 548.548 leke,
- shpenzime tetefoni ne shumen 635.810 leke,
- shpenzime per eksperte ligjore e eksp gjykate 490.000 leke,
- azhornim finance 830.740 leke,
- shpenzime per roje private ne shumen 2.092.800 leke,
- shpenzime per punonjesit uje, rroba ne shumen 344.588 leke,
- shpenzime per mirembajtje 76.500 leke,
- shpenzime transporti ne shumen 2.813.968 leke,
- shpenzime komisioni banke ne shumen 373.034 leke,
- shpenzime taksa, tatime ne shumen 2.456.978 leke,
- shpenzime reklame 405.000 leke,
- shpenzime gjoba ne shumen 281.541 leke,
- shpenzime noteriale ne shumen 178.033 leke,
- sherbim doganore ne shumen 99.167 leke,
- certifikate iso ne shumen 184.905 leke,
- kanceleri ne shumen 139.358 leke,
- te ndryshme 509.493 leke, analiza, kontroll periodik, blloqe, shpenzimi aplikimi ne Qkb, gjykate, detergjente e materiale higjienike etj.

Shpenziomet financiare ne shumen 6.717.631 leke paraqesin interesa huaje.

Rezultati ushtrimor neto qe shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj është fitim 16.628.528 leke.

Administrator
Ing. Albert Zogo



6974
13.07.20
